

Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Lënda: Kthim përgjigje

1 message

Eranda Bedalli <Eranda.Bedalli@kultura.gov.al>
To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Thu, May 11, 2023 at 6:17 PM

Z. Dorian MATLIJA
Drejtor Ekzekutiv
Qendra "RES PUBLIKA"
Bulv. "Gjergj Fishta", nd. 24, h.3, ap. 7

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 25/23 prot, dt. 03.05.2023, drejtuar Ministrisë së Kulturës me objekt "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit", bazuar në Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit", Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike; në shërbim të informimit të qytetarëve , ju bëjmë me dije se:

1. Projekt-propozimet e shpallura fituese ne Thirrjen 2023 do të mbështeten në shumën totale prej **165.120.000**lekë nga Programi "Art dhe Kulturë", llogaria ekonomike 604 – "Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur". Vlerat për secilin projekt fitues janë në negociim, proces i cili vijon në varësi të datave të zhvillimit të aktivitetve të projekteve.

2. Kolegjiumi i cili shqyrtoi, vlerësoi dhe paraqiti për miratim pranë Ministrit të Kulturës projektet e shpallura fituese, ngritur me Urdhër të Ministrit të Kulturës nr.156 prot, datë 09.03.2023, përbehej, bazuar në nenin 27 të Ligjit nr. 10352, dt. 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", nga:

- Irena Prici, Drejtor , DPSZHK
- Agim Bajko, Drejtor i QKKF
- Altin Basham Drejtor i TK
- Sokol Muça, Drejtor i IKRTK
- Gjergj Prevazi, Drejtor i TKEKS

3. Politikat e ndjekura nga Kolegjiumi për shqyrtimin, vlerësimin dhe propozimin pranë Ministrisë të Kulturës të projekteve fituese janë bazuar në zbatimin e politikave, objektivave dhe qëllimeve të Ministrisë së Kulturës, mbështetur në :

- Ligjin nr. 10352, dt. 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën"i ndryshuar,
- Udhëzuesin e Thirrjes
- "Rregulloren për mënyrën e funksionimit të Kolegjiumit".

4. Kolegjiumi, gjatë punës për shqyrtimin, vlerësimin dhe propozimin pranë Ministrisë të Kulturës të projekteve fituese për Thirrjen 2023, u bazua në ligjshmërinë, barazinë e të drejtave të personave, cilësinë dhe përmbajtjen, shtrirjen gjeografike, shtrirjen kalendarike, diversiteti në gjini artistike, përshtatshmërisë së projekt-propozimit me objektivat e Thirrjes, efikasitetin dhe besueshmërinë realizuese të projektit, vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e projekt-propozimit, buxhetimi në raport me cilësinë artistike të projekt-propozimit. Gjatë punës së tij voluminoze të shqyrtimit të 741 projekt-propozimeve të paraqitura, Kolegjiumi ndoqi me rigorozitet politikat e përfshirjes të të gjitha disiplinave artistike si festivale, ekspozita, edukim përmes kulturës, trashëgimi kulturore, tour-c virtuale, muzikë, balet, industri kreative, teatër, arte pamore etj.

Gjithashtu, pa mënjeluar parimin e barazisë në aplikim dhe vlerësim, Kolegjiumi ndoqi politika të mbështetjes së grupeve të marginalizuara, duke propozuar projekte të paraqitura nga përfaqësues të kësaj kategorie, si dhe duke propozuar projekte me përmbajtje të cilat ndikojnë në trajtimin e problematikave që këto grupe bartin.

Duke ju falenderuar sinqerisht për angazhimin tuaj dhe bashkëpunimin,



**KURSEJME
ENERGIJE
QË TA KEMI!**

Informacioni i transmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, transmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të transmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct.